

## NJË DIJETAR E PATRIOT QË MERITON NJË VEND TË VEÇANTË NË PANTEONIN KOMBËTAR TË DIJES DHE TË ATDHEDASHURISË

### Në vend të prologut

Një vit më parë, gjatë vizitës së studiueses së pasionuar Manushaqe Halili në zyrën time, ajo më dhuroi serinë prej tri vëllimesh, të titulluar “*Hoxha Tahsin, Vepra, I, II, III*”, të përgatitura prej saj. Para largimit, si kalimthi, ajo foli dhe për një vëllim të ardhshëm, për të cilin më kërkoi dhe kontributin tim konkret, pra për të shkruar edhe unë diçka në nderim të këtij shqiptari dhe rilindësi të shquar. Meqë m’u ofrua dhe koha për ta pasqyruar këtë angazhim, i dërgova një e-mail kolegut dhe mikut tim, Ekmeleddin Ihsanoglu<sup>1</sup>, me të cilin jemi anëtarë të Bordit të të Besuarve (Board of Trustees), të Bibliotekës Aleksandrina (në Aleksandri, Egjipt). Në përgjigjen e tij (faksimilja e përgjigjes i është bashkëngjitur shkrimit), krahas dhënies së disa referencave<sup>2</sup>, ai e konsideronte Hoxha Tahsin Efendiun si “*një nga pionierët e shkencave moderne të shekullit të XIX në Perandorinë Osmane*”, ndërkohë që në pjesën e fundit të letrës flet për librin e tij në dy vëllime, të botuar në turqisht më 2017-n, të titulluar “*Trashëgimia Shkencore*


- 
- 1 Ekmeleddin Ihsanoglu është një dijetar, diplomat e politikan turk. Ai është anëtar i Parlamentit Turk dhe i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Në periudhën 2004-2013, ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm i OIC (Organization of Islamic Cooperation). Po ashtu, ka qenë themelues dhe drejtor i Qendrës Kërkimore të Historisë, Artit e Kulturës Islame (IRCICA), themelues e profesor në Departamentin e Historisë së Shkencës, pranë Universitetit të Stambollit dhe ligjërues e referues në shumë universitete të Europës dhe SHBA-së. Ka botuar mjaft libra, punime e artikuj në gjuhë të ndryshme mbi shkencën, historinë e shkencës apo të marrëdhënieve midis botës myslimane dhe asaj perëndimore. Është nderuar me medalje dhe urdhra nga kryetarë shtetesh, mbretër e presidentë apo me “*Doctor Honoris Causa*” nga mjaft universitete të botës. Për kontributin dhe vlerat e tij të veçanta, ai u përzgjedh edhe si kandidat presidencial në zgjedhjet e vitit 2014 në Turqi, ku dhe fitoi afro 38.5 % të votave.
  - 2 *History of the Ottoman State, Society and Civilization*, botuar edhe në shqip: “*Historia e Shtetit, Shoqërisë dhe Qytetërimit*”, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë, 2009. Një botim i rëndësishëm i E. Ihsanoglu, i titulluar “*House of Sciences: Darülfünun*”, do të dalë vitin e ardhshëm nga Oxford University Press, ku flitet mbi rolin e Hoxha Tahsinit si drejtues i Universitetit Osman (Darülfünun).

*Osmane*” (Osmanlı Bilim Mirası). Aty, ai e “*ka përzgjedhur Hoxha Tahsinin si një nga 290 dijetarët e shquar midis mijërave prej tyre, gjatë periudhës së gjatë osmane 6-shekullore*”. Një diskutim të frytshëm patëm së bashku, në Rigë (Letoni), gjatë një takimi ndërkombëtar<sup>3</sup> (prej tij, në çdo rast, mund të përfitohet shumë).

## Hoxha Hasan Tahsini

Hoxha Tahsini, i njohur në fëmijëri si *Hasan Hoxha*, ka lindur në vitin 1811<sup>4</sup>, në fshatin Ninat, afër qytezës Filat të Çamërisë, në Vilajetin e Janinës. Kur shkoi në Stamboll për t’u shkolluar, në sajë të radhitjes së emrit pas mbiemrit në gjuhën turke, ai u quajt *Hoxha Hasan*. Aty, për rezultate të larta në mësim, iu dha titulli “Tahsin” (shembullor). Që nga ajo kohë, ai titull iu bashkëngjiti emrit e mbiemrit të tij në radhitjen: mbiemër, emër, titull – Hoxha Hasan Tahsin. Sidoqoftë, në të gjitha materialet e botuara prej tij, ndeshet thjesht emri Hoxha (Hoca) Tahsin<sup>5</sup>.

Një trajtim tepër të hollësishëm mbi Hoxha Tahsinin e ndeshim te Mehdi Frashëri<sup>6</sup>. Në mënyrë të veçantë, ai shpreh në atë shkrim shqetësimin e tij për njohjen e pakët të veprës së Hoxha Tahsinit. Midis të tjerash, ai thekson:



- 3 XVI High Level Meeting, “*Rebooting the European Project: New Vision for a United Europe*”, 28-29 November, 2018.
- 4 Vlen të theksohet se në referencat e sugjeruara nga E. Ihsanoglu ndeshet, po ashtu, edhe datëlindja 1228/1813.
- 5 Shih, p.sh., Ekmeleddin Ihsanoglu, *Osmanli Bilim Mirasi-Seçmeler, Yapı Kredi Yayınları, (YKY), 2017.*
- 6 Mehdi Frashëri, *Hoxha Tahsini – Nga ushtarët e panjohur të lirisë shqiptare*, “Minerva”, shtator-tetor, f. 23-29.

*“...jetëshkrimi, sistemi filozofik, gjërësija e dijenisë së tij dhe vepërat e tij pothuajse këtu në Shqipëri janë krejt të panjohura; dhe nga titulli “hoxhë” bota kujton se ky njeri do të ketë qenë ndonjë hoxhë si gjithë të tjerët; kurse puna nuk qëndron ashtu. Hoxha Tahsini..., si shënjë hoxhe ka pasur vetëm sarëkun dhe xhyben, por nga dituria dhe mentaliteti ka qenë me gjithë kuptimin e fjalës një dijetar i vërtetë dhe një filosof i shekullit ku jetonte” (f. 23).*

Po në atë shkrim, ai ka qëndruar gjatë dhe në vlerësimin e Sami Frashërit mbi Hoxha Tahsinin, si mishërim të parimit:

*“Kërko diturinë që nga djepi gjer te varri” (f. 27).*

Në të vërtetë, për thellësinë dhe gjerësinë e dijeve shkencore e shoqërore, për kontributin e tij të gjithanshëm, Hoxha Tahsini mund të konsiderohet si një nga figurat e shquara të kulturës shqiptare, në përgjithësi, dhe asaj të Rilindjes Kombëtare, në veçanti. Për më tepër, sipas M. Frashërit<sup>7</sup>:

*“Hoxha Tahsini nga pikëpamja e shqiptarizms, munt të konsiderohet si mjeshtëri i Sami Beut, Ismail Qemalit, Vaso Pashës, Daniel Oparakut e disa të tjerëve të rinjë shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë në fillimin e lëvizjes kulturore shqiptare, më 1879, në Stamboll”.*

Por Hoxha Tahsini është edhe një personalitet me zë në historinë e shkencës dhe arsimit osman, jo thjesht e vetëm si rektori i parë i Universitetit Osman (Stamboll), apo si një ligjërues i spikatur në shkencat sociale e ato natyrore, por dhe si autor i talentuar në mjaft botime shkencore e letrare<sup>8</sup>. Vlen të theksohet, po ashtu, se Hoxha Tahsini punoi edhe për alfabetin shqip. Ai e donte atë të ndryshëm nga alfabetet e gjuhëve të tjera<sup>9</sup> dhe, mbi të gjitha, edhe shprehës të fuqisë së gjuhës shqipe, një stigmatizues të brendisë dhe dinjitetit të popullit të tij, një *“bazë të përparimit dhe zhvillimit”*<sup>10</sup> të tij.

7 Po aty, f. 28.

8 Më hollësisht, shih, p.sh.: *Hoxha Tahsini, Vepra 1, 2, 3*, përgatiti për botim: Manushaqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013 dhe Laurant Bica, *Profesor Hasan Tahsini*, “West Print”, 2009 (në 3 vëllime) etj.

9 Mbështetur në analizën e fonetikës së shqipes, Hoxha Tahsini ishte kundër përdorimit të alfabetit arab, latin e grek. Po ashtu, alfabeti i krijuar prej tij përmbante 38 germa, 30 bashkëtingëllore dhe 8 zanore.

10 Hoxha Tahsini, *Vepra 2*, përgatiti për botim: Manushaqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013, f. 133.

## Qëndrimi në Paris

Në mesin e shekullit XIX, pushteti osman e kuptoi se nuk mund ta ruante fuqinë, shtrirjen dhe peshën e vet perandorake pa rritjen e cilësisë së përgatitjes së burokracisë shtetërore edhe në këtë kuadër të rritjes së nivelit të edukimit. Madje, shumë protagonistë të administratës dhe elitës perandorake e konsideronin si të domosdoshme hapjen e universiteteve në hapësirën osmane. Për këtë qëllim, u dërguan në Perëndim individë të talentuar, për t'u pajisur me dije shkencore bashkëkohore. Ndër ta ishte dhe Hoxha Tahsini. Ai, më 1857, u dërgua në Paris, si për të studiuar për vete, ashtu dhe për t'u dhënë mësim fëmijëve turq në shkollën osmane, “*Mekteb-i Osmani*”.

Kjo theksohet qartë në dekretin përkatës, sipas të cilit ai u dërgua atje

*“...për të mësuar studentët e dërguar në Paris nga zyrat e shkollat e Perandorisë Osmane, si dhe për t'ua mësuar gjuhën e bukur turqisht nënshtrësve të krishterë të perandorisë, të ndodhur në Paris. Së fundi, për të studiuar, po ashtu, disa shkencë të programuara për t'u zhvilluar në universitetin e gatsëm për t'u hapur”<sup>11</sup>.*

Një pohim të përafërt e ndeshim dhe te Mardin<sup>12</sup>, sipas të cilit:

*“Hoxha Tahsin u dërgua në Paris nga Reshit Pasha, për të studiuar shkencat natyrore, me synim krijimin e një elite “ulema” me formim perëndimor. Ai qëndroi 12 vjet atje, duke vepruar dhe si “chaplain” në ambasadën osmane. Ndërkohë ai kishte edhe përgjegjësinë për të ruajtur besimin dhe moralin e studentëve në shkollën turke të Parisit”.*

Hoxha Tahsini, në vitin e parë të qëndrimit të tij në Paris, para regjistrimit në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin e Sorbonës, plotësoi dhe thelloi më tej njohuritë e veta, duke “rrëmuar” në bibliotekat e pasura të Parisit. Paralelisht me studimet për shkencat natyrore, ndoqi leksionet si i jashtëm edhe në disa fakultete të tjera, duke përvetësuar kështu njohuri të thelluara në fizikë e matematikë, astronomi e gjeologji, kimi e biologji, filozofi e psikologji.

11 Sipas fletores zyrtare “*Xberide-i Havadis*”, datë 14. Xhemadi-ul-àhër 1273 H. (10. X. 1857).

12 Şerif Mardin, *The Genesis of Young Ottoman Thought, A Study in the Modernization of Turkish Political Ideas*, Syracuse University Press, 2000, f. 222.

## Hoxha Tahsini si rektor i universitetit të parë osman

Në veprën madhore “Historia e Shtetit, Shoqërisë dhe Qytetërimit”, midis të tjerash shkruhet:

*“Ideja për ndërtimin në Turqi të një institucioni të lartë të arsimit (të quajtur Dârülfünûn), lindi afër mesit të shekullit XIX. Zhvendosja e shkencës osmane nga Lindja drejt Perëndimit nisi në fillim të shekullit XIX dhe ndryshimet e mënyrës së përqasjes ndaj shkencës dhe arsimit ishin faktorë kyç në lehtësimin e ndërtimit të shkollave për arsim të lartë, përveç medreseve, gjatë periudhës së Tanzimatit”<sup>13</sup> (f. 465). Po aty, dy faqe më tej, thuhet: “Zyrtarisht, Universiteti Osman u formua më 8 maj 1869, sipas një dekreti perandorak”, por ai “u hap më 20 shkurt 1870, në një ceremoni madhështore të parë nga kryeveziri Ali Pasha, ministri i Arsimit Safvet Pasha dhe zyrtarë të tjerë të lartë shtetërorë. Tahsin Efendiu (Hoxha Tahsin), i cili kishte dhënë mësim në Shkollën Osmane në Paris, në vitin 1857, u caktua drejtor” (f. 467).*

Në fakt, me kthimin e Hoxha Tahsinit në Stamboll, në shoqërim të trupit të Mehmed Fuad Pashës, ish-kryetarit të Këshillit të Lartë të Perandorisë, të dërguar për kurim në Nisë (Francë), ai u ngarkua me ngritjen dhe drejtimin e universitetit. Vendimi për hapjen e tij ishte marrë disa vite më parë. Por Hoxha Tahsini shkoi më tej,

*“...duke ristrukturuar dhe programin mësimor edhe pse kjo binte ndesh me rregulloren” (f. 467),*

madje sipas botimit të cituar më sipër:

*“Ai bëri që të tri fakultetet të kishin të njëjtin program mësimor dhe i shfuqizoi ato, duke lënë të institucionalizuar vetëm disa lëndë të domosdoshme. Rezultati ishte se të gjithë studentët ndoqën saktësisht të njëjtat leksione. Universiteti vazhdoi punën deri në gushtin e vitit të tij të parë (1870). Në fund të vitit akademik, studentët dhanë një provim dhe atyre që dolën me sukses iu dha një certifikatë (shahâdetnâme). Klasat u mbyllën në fillim të vitit të dytë, për shkak të muajit të Ramazanit (Ramazan 1287/tetor 1870) dhe Tahsin Efendiu, drejtori i universitetit, organizoi leksione publike (dersi-‘am). Në njërin prej këtyre leksioneve të industrisë, letërsisë dhe*

13 Historia e Shtetit, Shoqërisë dhe Qytetërimit Osman”, AIITC, “Mileniumi I Ri”, Tiranë, 2009.

*teknologjisë, Xhemaleddin Afgani shpërndau një fjalim të mbajtur në ceremoninë hapëse të universitetit, ku ai fliste për artin. Në leksionin e tij ai përkufizoi artin dhe llojet e ndryshme të tij dhe në këtë kontekst foli mbi profecinë si një formë arti” (f. 468). Nga reagimet e ashpra që shoqëruan leksione të tilla, ato leksione u ndërprejnë. “Xhemaleddin Afgani u dëbua nga Stambolli. Drejtori i universitetit, Tahsin Efendi, u pushua nga puna si rezultat i këtij incidenti dhe zëvendësministri i Arsimit u caktua përkohësisht në vendin e tij. Edhe pse opinioni i përgjithshëm në shkrimet mbi historinë e arsimit osman thotë që Universiteti Osman u mbyll si pasojë e këtij incidenti, në të vërtetë mësimi vazhdoi deri në vitin akademik 1872-1873. Nuk dihet nëse ky institucion nxori të diplomuar apo jo. Më tej, nuk është tërësisht e qartë si dhe pse universiteti u mbyll” (f. 468)<sup>14</sup>.*

Një koment të ngjashëm për Hoxha Tahsinin e ndeshim dhe te Mardin<sup>15</sup>. Sipas tij:

*“...një eksperiment në fizikë i kryer prej tij, u bë dhe shkak i sulmeve të “ulema”-s mbi të. Për të ilustruar konceptin e boshllëkut, ai futi një pëllumb nën një kabanë qelqi. Ky boshllëk po krijohet kur po pompohej (tërhiqej) ajri që dëshmohej me asfiksimin dhe ngordhjen e zogut. Me këtë eksperiment, ai u ndodh para akuzave të bërjes së magjisë. I konsideruar kështu si një heretik, ai e ndërpreu dhënien e leksioneve dhe u largua nga kjo detyrë” (f. 222). Por ka shumë mundësi që “...universiteti u mbyll, ngaqë opinionet e avancuara të Tahsin Efendiut u çuan dhe u theksuan më tej edhe prej Xhemaleddin el-Afganit (po aty, f. 222).*

Të njëjtën ngjarje e përshkruan dhe Tekim Velu<sup>16</sup>. Edhe tek ai gjejmë këtë koment:

*“Një ditë, në një konferencë të mbajtur para një auditori, së bashku me një hoxhë me mendime përparimtare (Xhemaleddin Afgani) në godinën e Universitetit..., duke treguar praktikisht se si do të ngordhë një zog në një glob qelqi, kur t’i hiqej ajri. Kjo ngjarje u interpretua*

14 Shih për më hollësisht: E. Ihsanoglu, *Darülfünun Tarihçesine Giris...*, Bellefen 54, nr. 210, gusht 1990, 699-738.

15 Şerif Mardin, *The Genesis of Young Ottoman Thought – A Study in the Modernization of Turkish Political Ideas*, Syracuse University Press, 2000.

16 Tekim Velu, *Liria e mendimit dhe Hoxha Tahsin*, A. V. 49, Nr. Inventar 1059 (Material i përkthyer nga Ali Erebara, sipas fotokopjes së origjinalit të depozituar në Arkivin e Institutit të Historisë, Dosja S, 20 maj 1978).

*në ambientet e medresesë si një përzierje në punët e Zotit dhe, siç ndodh kurdoherë, si pasojë e pëshpëritjeve, u shkaktua një turbullirë ndërmjet nxënësve. Mbas kësaj, Hoxha u akuzua si njeri pa fe dhe universiteti u mbyll” dhe pak më tej shton: “Akuza që iu bë Hoxha Tahsinit, theu në atë kohë prestigjin dhe famën e tij dhe u bë shkak që ai të bënte një jetë të izoluar, deri në fund të jetës së tij”.*

Siç shihet, shkakun për dhënien fund të detyrës së tyre paraqitet me disa nuanca, por ajo që mund të veçohet, është edhe ligjërata e Xhemaleddin Afganit, në të cilën ai e quante profecinë si një lloj arti. Kështu, me gjithë interesin e madh për ligjërata e konferenca, ku diskutoheshin tema shkencore, kishte dhe struktura të prapambetura apo fanatike, si dhe individë konservatorë të elitës fetare e politike, që iu kundërvunë ashpër veprimtarive të tilla, madje duke i konsideruar ato në kundërshtim me fenë dhe besimin fetar, një kundërvënie ndaj Zotit dhe fuqisë së tij në shpjegimin e dukurive natyrore dhe të fshehtave pas tyre. Por tepër e dhimbshme ishte për Hoxha Tahsinit mbyllja e universitetit. Ai ishte një zhgënjim i madh për të dhe një goditje e thellë për kontributin e tij.

Pavarësisht nga koha e shkurtër në detyrë, Hoxha Tahsini mbetet shqiptari i parë që organizoi dhe drejtoi një universitet ndërkombëtar – atë osman, krahas dy qendrave të rëndësishme për kulturën e dijen shqiptare. Por largimi nga universiteti u shoqërua me goditje të tjera të egra ndaj tij. Pas qëndrimit në Shqipëri dhe kthimit në Stamboll, e akuzuan për krijimin e një feje të re. Kjo ishte dhe arsyeja e rikthimit në Stamboll dhe e izolimit të tij. Pas njëfarë kohe, me ndërhyrjen e Ismail Qemalit (në atë kohë sekretar në Ministrinë e Jashtme)<sup>17</sup>, ai u lëshua. Siç theksohet, po aty, para lëshimit, kur Hysni Pasha i shpjegoi arsyen e izolimit (bazuar në shpifjen që Hoxha Tahsini po krijonte një fe të re), ky i fundit iu përgjigj thjesht:

*“Fetë që ekzistojnë, jo vetëm që mjaftojnë për njerëzit e rruzullimit, por janë dhe të tepërta” (f. 24).*

## Racionalizmi (modernizmi) i Hoxha Tahsinit

*Europa e kohës së Hoxha Tahsinit kishte kohë që ishte shkëputur nga obskurantizmi mesjetar, ndryshe nga Perandoria Osmane që kishte mbetur tërësisht nën hijen e tij. Kurani ishte shtylla ligjore*

17 Mehdi Frashëri, *Hoxha Tahsini – Nga ushtarët e panjohur të lirisë shqiptare*, “Minerva”, shtator-tetor, f. 23-29.

apo kushtetuta e asaj perandorie shumëshekullore e shumëtnike. Por në gjysmën e dytë të shekullit XIX u bë e dukshme nevoja për një thyerje të kornizave të vjetra e tejet konservatore dhe për një ecje me më kurajë në përvetësimin dhe përhapjen e dijeve bashkëkohore. Kjo ndeshet qartë në analizën e asaj periudhe. Për më tepër “... gjatë periudhës së Tanzimatit dhe veçanërisht pas vitit 1859, kohë kur filloi letërsia e Tanzimatit, përhapja e dijës moderne u bë më sistematike. Dârülfünûn-i (universiteti), që në fillim ofroi diçka të ngjashme me leksionet e hapura publike, filloi dalëngadalë të krijonte rrethanat e përshtatshme për institucionalizimin e dijës dhe të procesit të të mësuarit... Ndërkohë që, deri nga fundi i shekullit XIX, kufijtë e dijës shkencore dhe të dijeve të tjera sistematike u zgjeruan dalëngadalë. Nëpër shkolla dhe nëpër institucione shkencore, intelektualët filluan të pushtoheshin nga dëshira për njohuritë enciklopedike. Përveç revistave krejtësisht shkencore si: “Mecmua-i Fûnûn” (1867) dhe “Mecmua-i Ulûm” (1879), faqet e revistave letrare ishin gjithashtu të përkushtuara për përcjelljen e dijës nga Perëndimi, te lexuesit e tyre”<sup>18</sup> (f. 146).

Po aty, në f. 151 theksohet se

“Hoxha Tahsin Efendiu (1813-1881) pasqyroj një racionalizëm më të ndrojtur, një racionalizëm në kuptimin e tij filozofik...”

Ai u dha një rëndësi të madhe matematikës dhe shkencave ekzakte dhe, ndonëse besonte në vlefshmërinë e dijës së përftuar nga eksperiencia, pra nëpërmjet ndjenjave, ai i qëndroi idesë se arsyeja ishte superiore ndaj ndjenjave në njësimin e dijës së mundshme, në bërjen e përgjithësimeve si dhe në të kuptuarit e ekzistencës. Përgjithësisht, Hoxha Tahsini ishte i hapur ndaj ideve të reja shkencore, por njëkohësisht nuk mund të dilte dhe as nuk doli jashtë kornizave të fesë islame. Ai përpigëj t’i ndërthurte ato në kërkim të të vërtetave të besueshme, në funksion të krijimit të një shoqërie të shëndetshme, në pikëpamje mendore e morale. Por një orientim i tillë e kishte bërë tepër agresive pjesën më konservatore e fanatike të “elitës” fetare. Shpjegimet në referimet apo ligjëratat e tij mbi gjithësinë dhe sistemin diellor, mbi mjaft dukuri natyrore, të cilat feja nuk i sqaronte dot në mënyrë racionale, ishin të papranueshme, një blasfemi e rrezikshme për atë lloj “elite”. Trajtesat e daljeve apo eksperimenteve të tij publike në fushat e shumta të shkencës kishin si synim t’u jepnin shpjegim dukurive

të shumta natyrore, të cilave feja nuk ua jepte dot në mënyrë racionale.

Mardin<sup>19</sup>, në librin e tij, pasi jep disa nga referencat e kohës të botimeve apo të përkthimeve të Hoxha Tahsinit, në f. 223, thekson: “Modernizmi i Tahsin Efendiut u shfaq qartë në botimin e një traktati të tij të parë në gjuhën osmane mbi psikologjinë. Po ashtu, ai shkroi dhe ekspozenë e parë të teorive moderne astronomike në një nivel popullor”. Dhe më tej, në f. 224 sqaron: “...nga fundi i jetës së tij, Hoxha Tahsini, duke jetuar në një dhomë të mbushur me instrumente shkencore, u përhoq të ndërtonte e zhvillonte Islamin mbi baza shkencore, duke marrë si pikënisje pandashmërinë e atomit”. Veçse për të, “...inkursionet e Tahsin Efendiut në modernizëm ishin më shumë kulturore” (f. 224). Kurse Sami Frashëri, kur fliste për dijetarët që zotëronin si dijet antike, ashtu dhe ato të reja, veçonte Hoxha Tahsinin si një përfaqësues të përbashkët të tyre, sepse ai jo vetëm shkruante mirë prozën e poezinë, por kishte njohuri të shëndosha edhe në matematikë, gjeofizikë e astronomi: “...ku nuk ishte i zoti vetëm në teori, por dhe aspektet e tyre praktike. Ishte shumë i thelluar dhe i brumosur në to, kishte hyrë thellë në brendësi, në bazat dhe ligjet e tyre”<sup>20</sup>. Mbi të gjitha, vetë Hoxha Tahsini, si një mësues i talentuar, kishte një dëshirë e gatishmëri për t’ua transmetuar pa u lodhur dijen studentëve dhe njerëzve rreth tij, i ushqyer dhe “...duke u bazuar në thënien e Profetit Muhamet (a.s.): “Kërkojeni diturinë prej djepit deri në varr”<sup>21</sup> (f. 46). Ndërsa, kur ai flet për domosdoshmërinë e shkencave racionale, shkruan: “Njeriu që kërkon të gjejë të vërtetën, kupton se subjekti i hulumtimit është e panjohura absolute. Nuk ka rëndësi nëse e panjohura ka të bëjë me ekzistenten (mevxhud) ose inekzistenten (gajri mevxhud)... Nëse ekzistentja nuk është materie, atëherë platforma racionale që merret me të, quhet metafizikë (ilmi ilaçi)”.<sup>22</sup> (V. 2, f. 164).

Kurse te Volumi 3 i përmbledhjeve të veprave të mësipërme, përfshihen shkrimet e reflektimet e veta në revistën e themeluar prej tij “*Mexhmua-i Ulum*” (*Mecmua-i Ulüm – Revista e Dijeve*), të cilën ai e drejtonte dhe

19 Şerif Mardin, *The Genesis of Young Ottoman Thought, A Study in the Modernization of Turkish Political Ideas*, Syracuse University Press, 2000.

20 *Hoxha Tahsini, Vepra 1*, përgatiti për botim: Manushaqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013, f. 7 (Sami Frashëri, *Revista Hafta (Java)*, Stamboll, 1881).

21 *Hoxha Tahsini, Vepra 1*, përgatiti për botim: Manushaqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013.

22 *Hoxha Tahsini, Vepra 2*, përgatiti për botim: Manushaqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013.

e mbështeste në mënyrë të gjithanshme. Ndër to, ka mjaft shkrime ku ai ndalon gjatë në vlerësimin e arsyes dhe fuqinë e dijes, në nevojën e argumentit dhe të lidhjeve dialektike shkak-pasojë.

Ja disa pohime pikante të tij:

*“Fuqia e njeriut është fuqia e arsyes... Çdo pyetje ka brenda saj një mijë fryte, ndërsa çdo përgjigje ka brenda saj begati të shumta për njeriun. Dituria është kapitali më i madh i njeriut. Injoranca është varfëri dhe dëm për të” (f. 119);*

*“Nuk ka gradë më të lartë se grada e dijes” (f. 122);*

*“Cilat janë shkaqet e prapambetjes shkencore e arsimore në popullin tonë?! A nuk janë ideologjitë e dëmshme të paraqitura nga njerëz të caktuar, ose fjalët dhe idetë e personave djallëzorë?!” (f. 123);*

*“Pasuritë natyrore kaluan nën kontrollin e njeriut nëpërmjet shkencës” (f. 124);*

*“Shkencat dhe artet në mënyrë më të përsosur, mund të na afrojnë pranë njohjes së bindshme të Zotit” (f. 125);*

*“Njeriu është sundimtari i materies dhe është në gjendje t'i përdorë fuqitë brenda materies për të mirën e racës së tij” (f. 126);*

*“Çdo shoqëri ballafaqohet me zhdukjen dhe vdekjen natyrore, pasi ka kaluar fazën e zhvillimit dhe të përsosjes. Gjatë historisë janë shkatërruar dhe zhdukur shumë popuj dhe shtete”, që në rastin e grekëve dhe romakëve “fundi i tyre ka ardhur për shkak të tharjes së gjakut në damarët e trupit shoqëror. Si rrjedhojë, trupi i tyre i plakur e kishte shumë të pamundur ripërtëritjen...” (f. 148);*

*“Aftësia e një populli për ripërtëritje, reformë dhe furnizim me vlerat e përparimit e të zhvillimit, është energjia e gjallërisë së tij” (f. 149).*

Siç kuptohet, Hasan Tahsini besonte tek arsimi, dija e shkenca, te gjuha e dituria si elementë kyçë në zgjimin e një populli. Ushqyer nga ky besim, së bashku me rilindës të tjerë shqiptarë, iu bashkua lëvizjes për ndërgjegjësim kulturor e politik, për zgjim e çlirim kombëtar, madje duke u bërë kështu një nga *“motorët e Rilindjes Kombëtare”*. Si një nga shqiptarët më të arsimuar dhe më të ditur, u vu në krye të lëvizjes për çështjen kombëtare, duke u bërë një nga nismëtarët e Shoqërisë Kulturore Shqiptare të Stambollit (1879) dhe ndër themeluesit e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881). Siç u tha, ai ishte, po ashtu, një nga të parët që hartoi një alfabet për gjuhën shqipe. Vëllezërit Frashëri apo atdhetarë të tjerë si J. Vreto, K. Kristoforidhi etj., ishin jo vetëm nxënësit, por edhe bashkëpunëtorët kryesorë të tij. Krahas

atdhetarizmit të tij të spikatur, Hoxha Tahsini si shkencëtar e filozof, krahasuar me dijetarë të famshëm të mesjetës arabe, është cilësuar nga Sami Frashëri si një *“Ibn-Sina shqiptar”*, kurse turkologu rus Smirnov,<sup>23</sup> në librin *“Përshkrimi i Historisë së Letërsisë Turke”*, (Petrograd, 1891) e cilëson Hoxhë Hasanin si *“Lomonosovin e Turqisë”*...

## Idetë filozofike-shkencore në botimet dhe ligjërimet e Hoxha Tahsinit

Hoxha Tahsini, edhe pse që në fëmijëri u njoh nga i ati me doktrinën fetare islame, arriti ta shikonte botën edhe nga një këndvështrim i thelluar shkencor bashkëkohor. Përpyekjet e tij ishin tepër të veçanta në pajtimin e fesë islame me shkencën, sidomos me teorinë atomistike të Demokritit (të atomeve si grimca të vogla të pandashme). Këtë ide atomistike e ndeshim qartë në librin e tij *“Sekretet e ujit dhe ajrit”*<sup>24</sup>. P.sh., në f. 94 ai shkruan:

*“Trupat në natyrë nuk janë përbërë vetëm prej një elementi, por ata janë përbërë prej tubimit të disa grimcave individuale, të cilat nuk kemi mundësi t'i shohim me shqisat tona dhe me disa mjete që posedojmë. Këto elementë, me ndikimin e fuqive natyrore, afrohen ose largohen prej njëri-tjetrit dhe trajtësohen me cilësi të ndryshme”.*

Por një ilustrim i veçantë dhe i gjithanshëm i ideve të Hoxha Tahsinit, një mishërim konkret i të menduarit dialektik të tij ndeshet te botimi i titulluar *“Historia e qenies ose e krijimit”*<sup>25</sup>. Kështu, siç thekson Nadiri Fevzi, në parathënien e atij libri, aty bëhet fjalë për *“pafundësinë e gjithësisë”*. Madje, sipas tij, kjo histori krijimi

*“...na tregon madhësinë e mijëra trupave qiellorë që, me urdhër të Zotit, lundrojnë në gjithësi, e krahas asaj madhësie, na tregon pafundësinë e gjithësisë. Në këtë pafundësi tregohet fuqia dhe madhështia e Zotit, mikrodimensioni i rruzullit tokësor si dhe parëndësia e llojit njerëzor”.*

Në konferencat e drejtuara nga Hasan Tahsini, që u shoqëruan sa me një interes masiv, po aq dhe me reagim armiqësor, lexohej qartë një

23 <https://islamansiklopedisi.org.tr/hoca-tahsin>

24 *Hoxha Tahsini, Vepra 1*, përgatiti për botim: Manushqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013, f. 81-152.

25 *Hoxha Tahsini, Vepra 1*, përgatiti për botim: Manushqe Halili, “Onufri”, Tiranë, 2013, f. 37-80. Ky libër në përkthimin shqip ndeshet dhe me titullin *“Historia e Formimit të Botës ose Krijimi” (Tarihi tekvin yahut Hilkat)*.

përzierje e thellë e shkencave moderne, sidomos mbi “pafundësinë e madhe dhe atë të vogël”. Megjithatë, Hoxha Tahsini nuk qëndron vetëm aty, por merr në shqyrtim edhe pafundësinë e kohës. Kështu, p.sh., në f. 45, ai bën fjalë për:

*“..kapitujt në lidhje me krijimin e Gjithësisë..., e cila e mëson njeriun me fillimin dhe fundin e tij. Koha është një fillim pa shtyllë dhe një lumë pa fund, që rrjedh hovshëm drejt ndryshimeve qiellore. Ajo prek veprimtarinë e pandërprerë dhe mund të thuhet pa frikë, se është esenca e kuptimit të krijimit”*

dhe pak më tej, në f. 46, ai shton:

*“Lëvizja e orëve tona është përcaktuar me sekonda, ndërsa lëvizja e kohës së pafundme është përcaktuar dhe sqaruar me mijëvjeçarë”.*

Në disa faqe më tej, në f. 53, sqaron dhe konceptin e tij kohor të zhvillimit njerëzor:

*“Kushedi sa mijëvjeçarë e shekuj i janë nevojitur njeriut për të arritur këtë gradë zhvillimi! Kushedi në sa vende dhe sa shumë herë popujt e kaluar janë shkatërruar si pasojë e ndryshimeve tokësore e qiellore!...”*

Të menduarit e tij dialektik dhe evolucionar zhvillohet akoma më qartë në f. 55, kur flet për reagimin antievolucion të kundërshtarëve dhe akuzuesve të tij. Sipas tij, ata

*“...nuk kanë dëshirë të shohin hallkat, të cilat përbëjnë zinxhirin e periudhave të ndryshme të Gjithësisë.... Thënë shkurt, ashtu siç ngjarjet e sotshme janë rezultat i ndikimeve të së shkuarës, ashtu dhe e ardhmja do të jetë prodhim i së tashmes... Pranimi i krijimit dhe ngjarjeve pa shkaqe është rrugë e të shtrembërve, e papëlqyer nga ana e filozofëve dhe të urtëve dhe plagë për dijetarët e thellë. Me studimin e shndërrimeve natyrore të ngjara në rruzullin tokësor, me kalimin e shekujve do të vërtetohen edhe ndikimet e shkallëzuara të shkaqeve tradicionale dhe do të duket mendimi i gabuar i të vjetërve, lidhur me ndikimin e shkaqeve mbinatyrore”. Dhe pak më tej, për të, “...duke u bazuar në mendimin e plotësisht natyror (evolucionit sh. p.) si dhe përparimit të pandërprerë, çdo ngjarje duhet të ndërlihet me një tjetër dhe për çdo pasojë duhet të mendohet për shkakun e saj” (f. 58-59).*

Është interesant gjykimi i tij mbi energjinë e grimcave të energjisë diellore, edhe pse në kohën që Hoxha Tahsini shkruante këto radhë, nuk ishte zbuluar akoma teoria kuantike, apo që rrezatimi, krahas natyrës valore, mund të shfaqte dhe një sjellje grimce, apo të gëzonte dhe një natyrë kuantike. Kështu, sipas tij:

*“Dielli është burimi i jetës së planetëve dhe të gjitha energjitë tokësore e shfrytëzojnë energjinë diellore. Nxehtësia që ngroh dhomat tona me djegien e lëndëve djegëse si dhe nxehtësia që është ruajtur te bimët, është energjia e grimcave të energjisë diellore... Pra, çdo lëvizje që paraqitet në planetin tonë është rezultat i nxehtësisë diellore” (f. 61-62).*

Kurse në disa radhë më tutje shkruan:

*“Edhe dielli është i krijuar... në gjithësinë e pafund, sistemi diellor është si një pikë dhe, përveç gjithësisë sonë, deri më sot, janë të njohura 4500 gjithësi të tjera; me miliona diej dhe përreth çdo dielli ka planetë si toka, por edhe më të mëdhenj. Disa prej tyre janë sapo të lindura, disa janë në pjekuri, disa janë plakur, disa kanë vdekur” (f. 62-63).*

Ia vlen të citohen këtu edhe disa radhë të tjera, që sintetizojnë shikimin pararendës e parashikues të këtij dietari mbi botën dhe ndërtimin e saj. Sipas tij:

*“...shkenca e kimisë bëhet shkas për arritjen në periudhën e lashtësisë botërore dhe në botën e gjerë të materies së pandashme (atomeve p.sh.). Edhe materiet primare si dhe gjithësia janë fryte të veprave të panumërta dhe rezultat e prodhim i kohëve të pafundme.... Thënë shkurt, nën udhëheqjen e saj, shkelim në një botë të lashtë ku toka, dielli, sistemet diellore dhe planetët e tjerë ende nuk kishin dalë në arenën e ekzistencës. Tani, ne e kemi kaluar kufirin e sistemeve diellore dhe jemi një shkallë më lart se shkallët e krijimit, në periudhën e substancës primare të gjithësisë” (f. 65).*

Por ai shikon më larg kur shton:

*“...prapëseprapë ndikimin e forcës së gravitacionit e shohim edhe në periudhën para veprimtarisë kimike dhe kjo na shtyn në një domosdoshmëri” (f. 66), madje, pak më tutje ai shtron dhe pyetjet pasuese: “Vallë, shkenca për mbajtjen e peshës është eterne nga*

*aspekti kohor dhe hapësinor, apo jo?... Po materia primare dhe energjia, a janë eterne dhe nuk kanë fillim? Është fakt, nëse një gjëje i thuhet se është eterne, më pas nuk ka kuptim të thuhet se ka fillim. Ja pra, në këtë pikë arsyeja ndalet” (f. 66).*

Është interesante, se si disa rreshta më poshtë, duke besuar në fuqinë e intelektit, ai bën dhe pohimin prognozë:

*“Mendja e njeriut, e cila shëtit në mes teorisë se gjithësia ka një fillim, si dhe mendimit të kundërt, do të përjetojë një shndritje në këtë pikë të errët dhe të çuditshme” (f. 67).*

Po aq të fuqishme janë dhe disa pohime të mëvonshme, që në një pamje ideore më të përpunuar, të shoqëruar dhe me një aparat matematik të sofistikuar, ndeshen në teori bashkëkohore mbi universin dhe fazat kryesore të krijimit të tij. Kështu, p.sh., në f. 70 të asaj vepre, jepet historia e krijimit të gjithësisë, me shtatë shkallëzime të zhvillimit dhe transformimeve të pandërprera. Aty, midis të tjerave, në f. 70 – 71, pohohet se:

*“...me bashkimin e pjesëzave të vogla dhe me dendësimin e materies primare, janë krijuar qendrat diellore. Me rrotullimin e qendrave diellore janë krijuar unaza, me këputjen e të cilave janë formuar planetët”. Për të, një histori e tillë lidhet me “...kohën e krijimit dhe shkatërrimit të gjithësisë, animin natyror të gjithësisë për plotësim e përsosuri të pandërprerë”. Në f. 74-75, Hoxha Tahsini i rikthehet kohës dhe pafundësisë së saj. Madje, nisur nga fakti që: “ngjarjet e kohës së tashme nuk janë asgjë tjetër, veç rezultatit i kohërave të kaluara”, ai shtron pyetjen: “A mund të dyshohet se ngjarjet e së ardhmes do të jenë përfundime dhe ngjarje të ndikuara nga e tashmja? Ardhmëria e përherëshme e kohës eternale do të jetë e pafundme, ashtu si edhe e kaluara e përherëshme që ka qenë para nesh”.*

Për më tepër, sipas Hoxha Tahsinit, ky univers nuk është statik. Ndër të tjera, ai pohon:

*“Gjendja e tanishme e botës, me ndryshimin e distancës ndërmjet planetit të tokës dhe diellit pas një miliardë shekujsh, nuk do të jetë e njëjtë me atë të asaj kohe. Njerëzimi ka filluar dhe do të sosit, toka është krijuar dhe do të përfundojë. Bota diellore, ashtu siç ka fillim, ashtu do të ketë dhe fundin e saj” (f. 75). I ndodhur para këtij përfundimi logjik, brenda binomit fillim-fund apo lindje-vdekje, ai tenton të gjejë zgjidhjen te njeriu dhe dijet e tij. Për të: “...është e*

*mundshme që disa dijetarë, sipas parimit të vërtetë “dija është forcë”, të kenë njohuri të mëdha dhe të formojnë një sundim të pafund dhe të pengojnë mjegullat e shkatërrimit të botës! Për to, ka mundësi të mos ekzistojë distanca dhe me depërtimin në valët e kohës dhe hapësirës të dhunojnë kufijtë e yjeve ose fatit. Në atë kohë, gjithsesi, planifikues dhe mbret do të jetë fuqia e dijes, mendjes dhe planifikimit” (f. 76).*

## Bazat e Astronomisë

Hasan Tahsini ka shkruar e botuar një mori veprash e artikujsh. Por ajo që njihet sot nga shkrimet e tij, është vetëm një pjesë e tyre. Kështu, ai shkruan traktatin e parë të psikologjisë në variantin osman, të titulluar “Psikologjia ose Shkenca e Shpirtit”, librin për astronominë moderne, të titulluar “Bazat e Astronomisë” etj. Me vlerë janë konsideruar edhe disa përkthime të veprave shkencore për fizikën dhe shkencat filozofike, ndër të cilat vlen të përmendet këtu përkthimi i librit “Loi Naturelle” (Ligji Natyror) i François de Chassebœuf. Le të ndalojmë tani kalimthi te *bazat e astronomisë*<sup>26</sup> dhe *poezia e gjithësisë*<sup>27</sup>. Aty sqarohet se rreth diellit vijnë rrotull satelitë dhe çdo yll qendror lëshon zjarr e dritë, madje sipas të dhënave të kohës, *me syrin përtej shikues astronomët caktojnë nja pesëqind mjegullina përtej “Kashtës së Kumtrit”, secila me miliona diej, ku çdo diell noton në qiell me satelitët e tij...*

Por, për Hoxha Tahsinin, po aq e veçantë dhe e habitshme nga thellësia dhe gjerësia e yjeve është edhe bota që tregon mikroskopi në një pikë uji. Madje, në jetën e shkurtër të kësaj bote minutat janë vite dhe në jetën e gjatë të yjeve vitet janë minuta, gjë që është provuar me aritmetikë e

26 Hoxha Tahsini, *Bazat e Astronomisë*, përkthyer nga Vexhi Buharaja dhe Abdulla Rexhepi, materiali i përgatitur për botim për vëllimin 4 të veprave të tij në gjuhën shqipe.

27 Te Mehdi Frashëri (Mehdi Frashëri, *Hoxha Tahsini – Nga ushtarët e panjohur të lirisë shqiptare*, Minerva, shtator-tetor, f. 23-29) jepet poezia filozofike e Hoxhë Tahsinin, e shkruar në një pajisje të ndërtuar prej tij. Ja disa fragmente nga ajo poezi, të quajtur “Tabela astronomike”, duke ruajtur variantin e saj në botimin e autorit: “Më e shumëta e dispozitave fetare ka të bënë me astronominë...!” “Për të hipur në kulmin’ e lartë të Qiellit/ Ndarjet’ formojnë shkallë dhe vijat’ litar të fortë;/ “Rreth Diellit’ vijnë rrotull satelitët/ Dhe ç’do yll qëndruar lëshon zjarr e dritë;/ Dielli me gjithë satelitët në Kashtën’ e Kumtrit formon një pikë. / Edhe trupi i Dheut, në botën’ e Diellit është një drudhë./ Gjithë rrotulluesit janë të banuar si Dheu, / Si dhe neve jetojmë’ e gëzojmë./ “Ç’do mjegullinë ka me miliunera Diej./ Ç’do Diell noton në Qiell me satelitët’ e ti. / Forma e përgjithëshme e botave’ është një lëshim i math pa an’ e pa funt/ Dhe qendër’ e sajë ndodhet’ kudo; // Pa u-mendo! sa i math është’ ay lëshim/ Kur ç’do drudh’ e tija formon një sferë të artë/ Por më e çuditshme nga thellësia dhe gjerësia e yjeve/ Është bota që tregon mikroskopi në një pikë ujë/ Në jetën’ e shkurtër’ të kësaj bote minutat’ janë vite/ Dhe në jetën’ e gjatë të yjeve vjetet jan’ minuta./...”.

gjeometri. Po ashtu, brenda botëkuptimit filozofik e shkencor të Hoxha Tahsinit, fuqitë bimore apo ato organike në zanafillë kanë si burim diellin. Për më tepër, tërë përbërësit organikë, që nga fija më e thjeshtë e një gjethi e deri te qelizat që përbëjnë trurin e njeriut, janë në vetvete një rezervuar apo një depo e një energjie potenciale, që ka grumbulluar në vetvete dritën e diellit. Pra, asgjë nuk krijohet e asgjë nuk zhduket në natyrë, por vetëm shndërrohet nga një formë lëndore në tjetrën. Për më hollësisht, po citojmë këtu disa pasazhe nga ky traktat, nisur nga parathënia e Salih bej-zade Nadiri Fevzi. Konkretisht, në f. 18, duke ndaluar te graviteti, ai thekson:

*“...është e natyrshme që të nxirret konkluzioni, se vetia për të tërhequr trupat nuk kufizohet vetëm në materien e Tokës, por është një veti e çuditshme që shfaqet në pjesët e të gjithë trupave [qiellorë] dhe se, në çdo vend që vërtetohet se ka materie, domosdo është e pranishme aty dhe fuqia tërheqëse”. Në lidhje me këtë, në f. 28, vetë Hoxha Tahsini sqaron: “Dielli i vetëndriçuar është qendër e Tokës dhe e planetëve të tjerë dhe trup sferik (spheroids), që koordinon lëvizjet e tyre. Ashtu siç është burim i ndriçimit të universit, Dielli është dhe shkaktari i rritjes dhe kultivimit të bimëve. Prandaj dhe për ne në botën e mundshmes janë të dukshëm të gjithë yjet, siç është dhe Dielli”. Kurse në f. 35, midis të tjerash, thekson: “Në këtë hapësirë të pafund janë shpërndarë trupa qiellorë të pafund...” dhe pak më tej shton: “një verifikim i tillë përgënjeshtrohet fjalët boshe të cilat pohojnë se Toka përjashtohet nga korniza e ligjeve që veprojnë mbi planetët e tjerë...” (f. 37).*

Megjithëse Hoxha Tahsini, nga njëra anë, përpiqet të përfshijë dhe shtjellojë në veprën e tij fjalën e fundit të shkencës, nga ana tjetër, ai e ka merakun e përputhjes së këtyre të dhënave me fenë. Kështu, siç u citua më sipër në shënimin shtesë për M. Frashërin, Hoxha Tahsini te poezia e tij mbi gjithësinë, në f. 54, sqaron se:

*“Shumica e dispozitave të fesë mbështeten mbi astronominë!...Me krabët e astronomisë mund të ngjitesh aq lart/Sa të kuptosh fuqinë e të madhit Zot!”. Vlen të jepen këtu edhe njëherë disa vargje të tjera të tij në një përkthim më të mirë), në të cilët shprehet besimi për qenie të gjalla jashtë planetit tokë. Vargje të tilla janë: “Çdo yll i qiellit të lartë është një diell në vete;... Të gjithë planetët ashtu si Toka, banohen nga qenie të gjalla. Banorët e kozmosit, si ne gëzojnë të mira materiale... Të gjithë diejt lundrojnë në hapësirë,*

*së bashku me hënëzat e tyre”. Së fundi, për lexuesin mund të jenë me interes dhe dy radhët e mëposhtme, sidomos rreshti i dytë: “Të gjitha botërat të marra së bashku sferë (sferike) nga forma,/ Qendra e kësaj ndodhet kudo, pjesë të rrafshhta nuk ka...” (f. 55-56).*

## Në vend të epilogut

Në përmbyllje të këtij meditim, me peshë të veçantë më duken vlerësimet e filozofit Riza Teufiku (deputet i Adrinopolit)<sup>28</sup>. Ai, në shkrimin “*I ndjeri Hoxha Tahsin nga Filiati*”<sup>29</sup>, nisur nga mendimet dhe botëkuptimi i Hoxha Tahsinit, midis të tjerash, pohon:

*“Të gjitha sendet e gjalla që ekzistojnë në botë kanë prejardhjen nga drita e rrezeve të diellit, duke filluar nga më e thjeshta, që është gjetja e zakonshme e bimës e deri te qelizat e trurit, të gjitha sendet e krijuara duken se janë depozitimi dhe koncentrimi i rrezeve të diellit që në frëngjisht quhet “Energie Potentielle” (kudreti nekiine) d.m.th. depo e forcave. Edhe Hahsan Tahsini qe për këtë parim. Në këtë princip të madh kryesor, lidhur me filozofinë e natyrës së përgjithshme, kuptohet që jo vetëm besonte, por edhe mendimi i tij dukej në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë në atë broshurën e tij të vogël, që quhej “Hijet” (komosi). Dhe pak më poshtë, ai shton: “Ja, pra, në principin e ruajtjes dhe grumbullimit të energjisë, i ndjeri e kishte pranuar me gjithë thellësinë dhe rëndësinë e çështjes, prandaj edhe ne duhet të pranojmë se ai ishte ndjekësi dhe bashkudhëtari i filozofëve të përmendur si Meier, Spenser, Kant, Kont etj. Për fat të keq, nuk kemi hollësira dhe argumente mbi mënyrën e shpjegimit të formës dhe natyrës së filozofisë së shkruar prej shkencëtarit tonë, por nga disa fjali të vogla, të shkruara në broshurën e vogël të quajtur “Shkenca Psikologjike”, kuptojmë se i ndjeri Hoxha Tahsin kishte pranuar dhe ishte bashkuar në rrugën e këtyre dijetarëve të teorive të reja”.*

Pra, për të, kjo vepër e Hasan Tahsinit e ilustron më së miri orientimin e tij bashkëkohor. Sipas Riza Reufikut,

28 Riza Teufik Bej (1869 – 1949) ishte një filozof epiloglot, një poet e politikan liberal turk me origjinë shqiptare.

29 Riza Tevfik, *Filati Hoca Tahsin Merhum*, Musavver Arnavud, İstanbul 1327, I, 81-92. (citimet nga materiali përkatës në shqip, përkthyer nga Vexhi Buharaja).

*“...duke përjashtuar specialistët ndër dijetarët që jetojnë në kohën tonë, vetëm Isak Efendiu është i një niveli me të ndjerin H. Tahsin”. Dhe pak më tutje thekson: “Mendimet e reja filozofike, i pari njeri që i ka pranuar dhe i ka përhapur, ishte i ndjeri Hoxha Tahsin Efendiu. Ishte për të ardhur keq, se aty nuk e kuptoi asnjëri, nuk e kanë dëgjuar dhe veprat e tij janë zhdukur nga duart e mosmirënjohësve”. Por, mbi të gjitha, ai shpreh një dhimbje të thellë për mungesën e respektit ndaj veprës së Hoxha Tahsinit, përpjekjeve dhe kontributit të tij. Ndaj pyetjes: “Vallë, a e dini çfarë ka qenë e vetmja dhuratë për këtë njeri të madh e fisnik?! A e dini çfarë dhurate i dha populli këtij njeriu?!”, ai thjesht i përgjigjet po vetë: “I dha epitetin “Gjaur Tahsin”(Tahsin kauri)!” Dhe më tej shton: “Kështu, i ndjeri Hoxhë Tahsini hyri në vargun e këtyre njerëzve të mëdhenj që janë vrarë nga shpifje të tilla. Por në realitet, ai ishte njeri besimtar dhe monoteist (besonte në një Perëndi).*

Ai të gjitha krijesat i quante si një frazë ose si një copëz të librit të madh të kozmosit. Shikoni këtë strofë me mendim dhe dije të thellë:

*Dimensione të pafund janë fletët e librit të kozmosit/  
Ekzistenca e qenieve është dëshmitare e veprave të pafund/  
Është vetë dora e shtypur dhe e ruajtur në natyrë/  
Çdo qenie ekzistuese në botë është një thënie kuptimplotë”.*

Për Riza Teufikun, si një nga ndjekësit dhe dashamirësit e mëdhenj të Hoxha Tahsinit, pikërisht:

*“...në këtë strofë të kësaj poezie, shikohet një përlule dhe bindje përpara një force krijuese të madhe (Zotit) dhe madhështore që nuk mund të arrihet dhe nuk mund të kuptohet as prej një besimtari të mirë...”*

dhe, pak më poshtë, ai pohon se:

*“Hasan Tahsini përkulet me respekt përpara Krijuesit të madh”.*